

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.12.2020*

23.12.2020

Ora 17:35

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

1.Z.Illirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet

2.Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli,

Përfaqësues të partive politike:

1.PD (z.I.Kaso)

Z.I.Celibashi: Fillojmë seancën publike të Komisionerit Shtetëror, për shqyrtimin e disa akteve që janë në kompetencën e Komisionerit Shtetëror. Kemi pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Partisë Demokratike. Jam njoftuar që përfaqësuesi i Partisë Socialiste në KQZ për arsye shëndetësore nuk mund të marrë pjesë. Meqenëse nuk kemi konfirmime për pjesëmarrjen apo jo të përfaqësuesve të partive politike të tjera në KQZ dhe kemi tejkuluar kohën e fillimit të seancës, mendoj të vazhdojmë dhe nëq dikush do t'i bashkohet seancës, janë të mirëpritur, i kanë të gjitha mundësitë. Atëherë, sot kemi për shqyrtim dy çështje. Një çështje ka të bëjë me vendimin “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”. Akti tjetër ka të bëjë me projektudhëzimin “Për përcaktimin e rregullave për

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.12.2020*

depozitimim e verifikimim e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimim e listave të kandidatëve dhe miratimim e modeleve të kandidimit”.

Fillojmë me pikën e parë që ka të bëjë me caktimim e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Më së pari do t’u them që ky akt është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, bazohet në neni 19, paragrafi 1, shkronja”n” të Kodit Zgjedhor. Në mbështetje neni 29, paragrafi 4, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar se renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, bëhet mbi bazën e numrit të mandateve që ka fituar partia politike nga zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në mbështetje të neni 183, paragrafi 8, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, e drejta për propozimim e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimim shumicë-pakicë të Kuvendit të Shqipërisë në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Referuar vendimim nr. 555, datë 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017”, numri i mandateve të fituara nga partitë politike është si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë 74 mandate
2. Partia Demokratike 43 mandate
3. Lëvizja Socialiste për Integrim 19 mandate
4. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 3 mandate
5. Partia Social Demokrate e Shqipërisë 1 mandat

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.12.2020*

Ne, këtë projektakt e kemi dërguar për konsultim tek partitë politike, por dhe tek organizatat e shoqërisë civile. Kemi marrë komente prej përfaqësuesit të Partisë Politike, pra prej jush zoti Kaso.

Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike: Faleminderit zoti Komisioner. Jemi njohur me aktin. Më vjen mirë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në cilësinë e Komisionerit, ka bërë një reflektim të aktit në lidhje dhe me një vërejtje që ne ia kishim parashtruar paraprakisht Komisionerit për të cilën Komisioneri gjithashtu i është drejtuar Kuvendit, por pavarësisht përgjigjes evazive të Kuvendit, besoj se Komisioneri ka marrë të gjitha masat në mënyrë që ta përshtasë aktin jo vetëm me frymën, por dhe me germën e ligjit. Është bërë një ndarje e saktë në këndvështrimin tonë të subjekteve si nga ana e mazhorancës, ashtu dhe nga ana e opozitës, të cilët në bazë të Kodit Zgjedhor, por dhe të dispozitës tranzitore të aplikueshme vetëm për këto zgjedhje përfitojnë komisionerët. Me formën e aktit të reflektuar nga propozimi fillestar, shprehemi dakord. Kuvendi i Shqipërisë mund të mbante një qëndrim që të mund t'ia lehtësonte jetën Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në këtë pikë. Megjithatë besoj se KQZ-ja i ka marrë të gjitha përgjegjësitë e veta duke bërë një akt të saktë, duke e sjellë sot për miratim.

Z.I.Celibashi: Dakord, meqenëse nuk kemi ndonjë koment tjetër e konsideroj aktin të miratuar sipas projektit që ju është dërguar ju, ku në përbërje të komisioneve kemi përfshirë dhe Partinë Socialdemokrate. Pra,

- a) Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë 2 anëtarë në çdo KZAZ;
- b) Partia Demokratike do të propozojë dy anëtarë në çdo KZAZ;
- c) Partia Lëvizja Socialiste për Integrim do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ;

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.12.2020*

ç) Partia Socialdemokrate do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ;

Pastaj në raportin 50:50, raportin pozitë–opozitë anëtari i shtatë do të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, parti e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike.

Vendimi nr.40

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.12.2020*

23.12.2020

Ora 17:43

RENDI I DITËS

Projektudhëzim “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

1.Z.Illirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet

2.Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli

Përfaqësues të partive politike:

1.PD (z.I.Kaso)

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë seancën me aktin tjetër që ka të bëjë me projektudhëzimin “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”. Atëherë dhe ky akt është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet. Në dallim nga praktika e zgjedhjeve të shkuara, ne kemi synuar që ta thjeshtësojmë procedurën dhe modelet që do të duhet të aplikojnë në procesin e regjistrimit të subjekteve zgjedhore, duke e ulur numrin e këtyre modeleve duke i unifikuar disa modele në një model. Kjo mendoj se i shërben dhe subjekteve zgjedhore dhe lehtëson procedurat e regjistrimit për këto zgjedhje. Nuk e di nëse zoti Kaso keni ndonjë koment?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.12.2020*

Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike: Faleminderit zoti Komisioner. Jemi njohur me aktin. Ka disa risi në lidhjet e tij pasi ligji parashikon kësaj rradhe edhe dokumentacion tjetër shtesë, në raport me dokumentacionin që deri më sot paraqesnin subjektet politike. I referohem në veçanti deklaratës së kryetarit të partisë për angazhimin solemn për të hequr dorë nga përfshirja e subjekteve të tyre në praktika të paligjshme të shitblerjes së votës, të përfitimit të financimeve nga burime të dyshimta etj. Pavarësisht se nuk mendoj se ky akt do t'i ndalojë praktika të tilla nqs do të ishte ky qëllimi i subjekteve politike, por gjithësesi në kuadrin që tashmë është një detyrim ligjor i parashikuar në Kodin Zgjedhor. Kjo të paktën bashkë me momente të tjera le të themi dhe të verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit të pastërtisë për sa i përket kandidimit të subjekteve përbëjnë risi, reflektojnë atë që ka kodi. Për sa i përket afateve, pavarësisht se akti detajon dhe kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t'i marrë ato në shqyrtim dhe për t'i kthyer për plotësimet e nevojshme, afatet janë të përcaktuara nga ligji. Shprehemi dakord për aktin, vëmë re atë që thatë dhe ju që synohet reduktimi për të thjeshtuar dokumentacionin që për hir të së vërtetës është shumë i ngarkuar. Por duke konsideruar që për të gjithë subjektet të cilët regjistrohen për zgjedhje, qoftë koalicion, apo parti politike, në momentin që përmbushin detyrimin e tyre për të garuar në të gjitha zonat zgjedhore me numrin e kandidatëve që parashikon ligji, dokumentacioni është voluminoz për t'u paraqitur. Në këtë kuadër është për t'u përshëndetur përpjekja e KQZ-së për ta thjeshtuar sado pak këtë proces dhe për ta bërë më të aksesueshëm edhe nga subjektet e reja politike të cilat regjistrohen në zgjedhje dhe nuk kanë as eksperiencën, as burimet njerëzore të nevojshme për të plotësuar këtë detyrim ligjor në kohë. Kështu që shprehem dakord me aktin, faleminderit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.12.2020*

Z.I.Celibashi: Faleminderit zoti Kaso! Atëherë meqenëse nuk kemi ndonjë propozim për ndryshime të projektaktit, e miratoj projektaktin me tekstin ashtu sikurse ju është bërë me dije përfaqësuesve të partive politike. Në qoftë se nuk kemi gjë tjetër në lidhje me rendin e ditës, atëherë e konsideroj të mbyllur këtë seancë. Falenderoj zotin Ivi Kaso për pjesëmarrjen dhe kontributin, faleminderit anëtarëve të stafit të KQZ-së!

Udhëzimi nr.1

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*

